

**Nr. Prot. 015/B/18****VENDIM Nr.1170****Për****Miratimin e****“Rregullores për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”**

Në mbështetje të nenit 1, nenit 10, paragrafi 4), neni 69 paragrafi 1) dhe 2), neni 79, paragrafi 1) dhe 2) i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*); në përputhje me dispozitat e nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar i Bordit
- 2) z. Nijazi Ademja Anëtar i Bordit
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar i Bordit
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar i Bordit

në mbledhjen e 27-të me radhë të mbajtur më datë 03 Prill 2018, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamenti Ligjor (DL), unanimisht morri këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet **“Rregullore për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”** së bashku me dokumentin **“Konkluzione nga konsultimi publik i Rregullores”**.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”*

Neni 69 i Ligjit përcakton se *“Ndërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar ta publikojnë informacionin e duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej tyre.”*

Në përputhje me nenin 82 të Ligjit, ARKEP me Vendimin Nr. 1029 (Ref. Nr. Prot. 046/B/17) të datës 07 Korrik 2017, ka miratuar iniciimin dhe fillimin e procedurës së Konsultimit Publik të draft Rregullorës për kualitetin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Duke pas parasyshë atë që u tha më lartë si dhe me qëllim të implementimit të Kornizës Rregullatore të BE-së lidhur me net neutralitetin, respektivisht Rregullores Nr.2015/2120 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 25 Nëntor 2015 për përcaktimin e masave lidhur me qasjen në internetin e hapur, atëherë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit.

**Prishtinë, 16/04/2018**

#### **Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi  
Kryetar i Bordit**

#### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative;
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP;
- Departamentit Ligjor, ARKEP
- Arkivit, ARKEP